



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Miratimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001 dhe Protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr.8850/2001””.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Xhemal Qefalia, Anduel Xhindi, Vullnet Sinaj, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Spartak Braho dhe Klodiana Spahiu.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Andon Frrokaj, Luan Rama, , Paulin Sterkaj, Myslim Murrizi, , Isuf Çelaj, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Braimllari dhe Xhemal Gjunksi.

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Elona Hoxhaj - Drejtoreshë Juridike e Ministrisë së Brendshme

Armand Skapi - Drejtor i Marrëveshjeve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Sot në rendnin e ditës së kësaj mbledhjeje kemi miratimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001 dhe Protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në shelfin kontinental, aderuar me ligjin nr.8850/2001”.”.

Në fakt, është pak titull i ndërlikuar.

Për të prezantuar këtë projektligj kemi ftuar zëvendësministren e Brendshme, zonjën Rovenë Voda, zonjën Elona Hoxhaj, drejtoreshë Juridike e Ministrisë së Brendshme, si dhe zotin Armand Skapi, drejtor i Marrëveshjeve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Faleminderit!

Nga Komisioni për Sigurinë, relator është kolegu Vullnet Sinaj.

Zonja zëvendësministre do t’ju ftojë të bënit një prezantim të këtij projektligji, që me sa kuptohet edhe nga relacioni që shoqëron projektin lidhet me faktin që Republika e Shqipërisë ka aderuar qoftë në Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, po ashtu edhe në protokollin që ndalon akte të tilla që u kundërdrejtohen platformave fikse që vendosen në pjesën e shelfit kontinental.

Ju lutem, na prezantoni këtë projektligj në mënyrë të përmbledhur dhe sa më koncize. Më pas do të vazhdojmë sipas Rregullores me pyetjet dhe diskutimet nga ana e anëtarëve të komisionit.

Rovena Voda - Mirëmëngjesi!

Republika e Shqipërisë ka aderuar në Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar dhe Protokollin që ju përmendët që në vitin 2001. Dy protokollat e propozuara për aderim nëpërmjet këtij projektligji janë akte që ndryshojnë konventën dhe protokollin që e shoqëron atë, të ratifikuara me ligjin e vitit 2001. Është një akt i propozuar nga Ministria e Brendshme, por i sugjeruar nga Ministria e Jashtme. Ka kaluar të gjithë fazën e konsultimit të brendshëm, dua ta theksoj këtë gjë, është marrë mendimi edhe i Ministrisë së Mbrojtjes, edhe i ministrave të tjera të linjës, sigurisht

në bazë të Rregullores edhe të Këshillit të Ministrave. Është në programin analitik të akteve për vitin 2018, pra ka qenë i parashikuar që në fillim, kur është hartuar ky program.

Aderimi i RSH-së në këto dy protokolle synon forcimin e bashkëpunimit dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare Detare për të rritur efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit në aspektin e sigurisë detare, duke bashkëvepruar me organet përgjegjëse, si edhe marrjen e masave të përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, pra flasim gjithmonë nëpërmjet rrugëve detare, realizimin e objektivave nga palët në lidhje me evidentimin e shkeljeve të rregullave të përcaktuara në protokollet e konventës, legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi.

Përparësitë që priten nga aderimi i Republikës së Shqipërisë në këto dy protokolle lidhen me fushën e goditjes së krimit, akteve terroriste, sigurisë publike, në rrugë detare. Edhe një herë, siç e thashë, fjala kyçe e këtyre dy protokolleve është bashkëpunimi dhe përmirësimi i shkëmbimit të informacionit. Në kuadër të zbatimit të këtyre protokolleve, palët do të marrin masa të përbashkëta. Aderimi në këto protokolle është iniciuar mbi bazën dhe frymën e respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, në pajtim me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Do të thosha se nëpërmjet aderimit në këto protokolle, Republika e Shqipërisë bën të mundur realizimin e një hapi përpara drejt konsolidimit të kuadrit ligjor detar. Konkretisht, ndryshimet e propozuara janë sipas neneve që kanë protokollet, por mbase do të ketë edhe pyetje, ndaj që nuk po zgjatem më shumë.

Pikat kryesore të protokollit zgjerojnë fushën e zbatimit të konventës, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar shkeljet që përbëjnë veprë penale në zbatim të kësaj konvente. Rastet apo veprimet që nuk përbëjnë veprë penale rregullohen në legjislacionin përkatës kombëtar. Sigurisht, ka edhe një nen në këto protokolle që do të ratifikohen, ku është parashikuar që më pas, kjo mori e veprash penale, që shtohen nëpërmjet aderimit në këto dy protokolle, duhet të pasqyrohen. Pra, merret edhe një angazhim për t'u pasqyruar në legjislacionin e brendshëm penal të vendit tonë.

Një pikë që do të doja ta përmendja shkurtimisht, është se implementimi i zbatimit të këtyre dy protokolleve do të bëhet nga qendra ndërinstitucionale operacionale detare, QNUD-ja. Përveç Departamentit të Kufirit dhe Emigracionit, pra Policisë së Shtetit që monitoron kufirin tonë detar në bazë të ligjit për kontrollin kufitar, një ligj ky i përafëruar edhe me *Acquis* të BE-së, sigurisht, kemi edhe Ministrinë e Mbrojtjes, nëpërmjet *coast guard*, pra rojës

bregdetare, e cila edhe ajo monitoron dhe ka pjesën e saj të kontrollit të kufirit detar. QNUD - ja, meqenëse është qendra, e cila përmbledh të gjitha institucionet, është ajo që do të merret me implementimin e këtyre dy protokolleve.

Kosto shtesë në buxhetin e shtetit nuk ka. Pra, impakti nuk është negativ, nuk do të kemi kosto shtesë, pasi sigurisht, do të jenë të angazhuara ato burime njerëzore dhe logjistike që ka Policia e Shtetit apo institucionet e tjera.

Unë besoj se më vonë, me ratifikimin e këtyre dy protokolleve, sfida më e madhe do të jetë një lloj vlerësimi që do të duhet të bëjmë, përshtatja apo rishikimi i legjislacionit të brendshëm në lidhje me veprat penale që shtohen në kuadër të kësaj konvente.

Do të thosha se një vlerë e shtuar është pjesa e shkëmbimit të informacionit që përmendet këtu. Në fakt, në protokoll nuk jepen shumë detaje se si do të shkëmbehet. Unë besoj se detajet në shkëmbimin e informacionit do të bëhen me protokolle bilaterale, plane pune të përbashkëta, të cilat sigurisht do të jenë të mbështetura në protokollin bazë.

Faleminderit!

Faleminderit, zonja Voda!

Ermonela Felaj – Nuk e di nëse kishit diçka për të shtuar, zoti Skapi?

Armand Skapi – Nuk doja të shtoja diçka më shumë nga sa tha zëvendësministria Voda, por thjesht të theksoja se ky është një hap i rëndësishëm që ndërmerr parlamenti shqiptar në drejtim të aderimit në dy akte të rëndësishme ndërkombëtare në luftim kundër terrorizmit, në Organizatën Ndërkombëtare të Detarisë.

Deri tani, në këto dy protokolle janë bërë palë tridhjetë e nëntë shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara ndër të cilët pjesa më e madhe janë anëtarë të BE-së. Kështu që Shqipëria u bashkohet atyre vendeve, të cilët kanë ratifikuar deri më sot këto protokolle.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Fjala për zotin Sina.

Vullnet Sinaj - Faleminderit!

Doja të sqaroja pak në lidhje me titullin e ligjit dhe të saktësoja një dy gjëra, ndoshta më thellësisht.

Për projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001, dhe Protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin

nr.8850/2001”, doja të sqaroja se këtu kemi të bëjmë me aderimin e Shqipërisë në dy protokolle. Historia është e tillë që në vitin 1988, në Romë, Organizata Ndërkombëtare Detare ka ndërtuar një platformë dhe një protokoll. në konventë bëhet fjalë për sigurinë, për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar, kurse në protokoll bëhet fjalë për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse në në shelfin kontinental.

Në vitin 2001 ne kemi aderuar për herë të parë në të dyja këto, edhe në konventë , edhe në protokoll.

Në vitin 2005, edhe konventa, edhe protokollin kanë pësuar ndryshime, edhe konventa është ndryshuar me një protokoll të ri, edhe protokollin është ndryshuar me një protokoll të ri. Pra, sot bëhet fjalë për aderimin e Shqipërisë në të dy protokollin e vitit 2005, prandaj bëhet fjala protokoll – protokoll, sepse edhe konventa ka ndryshuar me protokoll, edhe protokollin është ndryshuar me një protokoll.

Kjo ishte sa për ta shpjeguar se pse këtu varet e gjithë ajo për të cilën po diskutojmë sot.

Aderimi i Shqipërisë në këto dy protokolle, parafolësit e thanë qartë, lidhet me sigurinë e lundrimit detar dhe ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së këtyre platformave fikse që janë në shelfin kontinental. Platforma fikse janë të gjitha ato platforma apo ishuj të ndërtuar në shelfin detar që kanë të bëjnë me furnizime të ndryshme të anijeve me naftë, me gaz, me vaj dhe ka të bëjë me ruajtjen e këtyre nga elementë keqbërës, të cilët mund të kërkojnë që për arsye destabilizimi apo të krijimit të problemeve me anijet apo me banorët e zonave që janë afër, mund të veprojnë me akte terroriste kundër tyre, dhe pikërisht në këtë protokoll bëhet fjalë për ndryshimin dhe zgjerimin e gamës, për marrjen e masave dhe parandalimin e këtyre akteve terroriste, ashtu siç bëhet fjalë edhe në protokollin e parë, që ka të bëjë me sigurinë e lundrimit detar, kanë marrë një zgjerim të madh në ndryshimet që kanë bërë në vitin 2005.

Në kuadrin e OKB-së këto ndryshime i përfaqëson Organizata Ndërkombëtare Detare, që është pjesë e OKB-së. Ne si anëtar të OKB-së kemi detyrën që të marrim pjesë dhe të aderojmë në këto dy protokolle së bashku me vendet e tjera në luftën kundër krimit në tërësi, kundër krimit të organizuar, si edhe kundër terrorit që mund të ndodhë në rrugët detare.

Njëkohësisht me këtë projektligj ne realizojmë sigurinë, luftën kundër terrorit, kundër krimit të organizuar, që janë pjesë e qëllimit strategjik të qeverisë “Rama”.

Ne jemi dakord me këtë projektligj.

Gjithashtu, ky projektligj bën avancimin e ligjit tonë detar dhe e përafron atë me ndryshimet e reja që kanë ndodhur në kohë.

Projektligji respekton rregullat dhe ligjet ndërkombëtare, por njëkohësisht respekton edhe ligjet e brendshme tonat. Ky projektligj është mbështetur në ligjin nr. 43 të vitit 2016, pikërisht në nenin 18, ku thuhet se aderimi është akti me të cilin Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur me një marrëveshje ndërkombëtare, e cila nuk është nënshkruar më parë sipas saj. Pra, në këtë rast, aderimi që ne po bëjmë është pëlqimi për t'u bërë pjesëtarë të ndryshimeve të kësaj marrëveshjeje.

Ndërsa në nenin 84 të ligjit nr. 108 të vitit 2014 për Policinë e Shtetit thuhet se policia bashkëpunon me policitë e shteteve të tjera ose me organizata ndërkombëtare policore, bazuar në marrëveshje kombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe. Pra, me këtë ligj ne i hapim rrugë bashkëpunimit të policisë sonë me policitë tjera të vendeve që marrin pjesë në këto dy protokolle, që janë pjesë e konventës së vitit 1988.

Në zbatim të ligjit është Qendra Ndërinstitucionale Operacionale, e cila vëzhgon hapësirën detare, garanton kontrollin e kufijve, garanton sigurinë e jetës në det, si dhe vëzhgon organizimin dhe drejtimin e tyre. Në qendrën institucionale operacionale detare bëjnë pjesë Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Financës dhe Ministria e Turizmit.

Unë mendoj se duhet të kishte nga një përfaqësues të këtyre ministrive në këtë mbledhje për të marrë masa për zbatimin sa më mirë të këtij ligji.

Zbatimi i këtij ligji nuk ka efekte financiare.

Të nderuar kolegë, për sqarime të tjera nen për nen, bëni pyetjet dhe do t'ju përgjigjen anëtarët e komisionit.

Unë do të doja të sqaroja termin “shelfin ndërkontinental”, kuptimi i të cilit është hapësira e tokës nëndet që fillon nga buza e detit deri në 200 milje në thellësi të detit ose atje ku fillon thellësia më e madhe e detit, është pjesa ku vendosen platformat fikse.

Duke shprehur mendimin që ky ligj forcon sigurinë tonë dhe ne bëhemi pjesë e sigurisë europiane mbarëbotërore për luftën kundër akteve terroriste ose krimit të organizuar, ju ftoj që ta miratojmë!

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Sinaj!

Unë kam një pyetje që u drejtohet të dy ministrive.

Vullnet Sinaj – Unë kam një pyetje, por nuk e di nëse ju do të jeni në gjendje të përgjigjeni. Përse këto ndryshime kanë ndodhur në 2005-ën dhe ne aderojmë në 2018-ën?

Pse kaq vonë?

Ermonela Felaj – Në fakt, është e njëjta pyetje që do të bëja edhe unë. Realisht, titulli, sepse nuk e di nëse do të gjendej mënyra për ta përkthyer më thjeshtë, titulli konfondon. Pra, të duhet të lexosh relacionin për të kuptuar se bëhet fjalë për një konventë dhe një protokoll që janë të '88-ës dhe që janë ndryshuar mandej në 2005-ën dhe pas 13 vjetësh ne duhet të aderojmë në to që t'i kemi këto ndryshime në legjislacionin tonë. Pse duhet që pas 13 vjetësh ne të detyrohemi, nga se është motivuar, pse kjo kohë kaq e gjatë, çfarë ka ndodhur?

Iniciatore ishte Ministria e Jashtme, por pyetje është për të dyja ministrinë.

Armand Skapi – Republika e Shqipërisë është bërë në shumë instrumente juridike ndërkombëtare si ajo e Kombeve të Bashkuara, e Këshillit të Europës dhe e organizatave të tjera. Jo çdo konventë menjëherë sapo ajo bëhet e hapur për nënshkrim, ne duhet të marrim menjëherë masa për ta nënshkruar, ratifikuar ose aderuar, sepse përpara se të bëhemi palë në një instrument juridik ndërkombëtar bëhet një vlerësim për rëndësinë e dokumentit, për kapacitetet që ka vendi ynë për të aderuar në këtë instrument, sepse të gjithë instrumentet juridikë ndërkombëtarë sjellin detyrimet për shtetin tonë, kështu që erdhi momenti për t'u bërë palë e këtij instrumenti.

Ju theksoj se janë 39 anëtarë palë në këto dy protokolle, numri nuk është ende i madh dhe ne renditemi në 40-n e parë të shteteve, të cilët bëhet palë në këto dy instrumente juridike. Praktikisht, nuk është një vonesë shumë e madhe në krahasim me vendet e tjera. Siç edhe jua thashë, është një pjesë e mirë e vendeve të Bashkimit European, deri tani janë 20 vende, prandaj janë ende vende që do të bëhet palë në të ardhmen në Bashkimin European, por e rëndësishme është që ne jemi në 50-n e parë të shteteve që janë bërë palë në këto dy instrumente.

Pra, nuk është një kohë relativisht e gjatë që ne jemi bërë pjesë në krahasim me instrumentet e tjera.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Pra, nuk kishte ndonjë gjë të veçantë që e nxiti vëmendjen drejt këtyre dy instrumenteve ndërkombëtarë? Çfarë e nxiti faktin që pas 13 vjetësh Shqipëria mendoj të bëhet pjesë e këtyre dy instrumenteve, përfitimi që vjen më pas nga këto apo një

situatë e veçantë që e detyron edhe institucionin tuaj që t'i sugjerojë, institucion, i cili, në fakt ka një përgjegjësi më të madhe, Ministrisë së Brendshme, që ne ta miratojmë këtë projektligj?

Armand Skapi – Objekti i këtyre dy protokolleve është lufta kundër terrorizmit, siguria kombëtare, ndërkombëtare, bashkëpunimi ndërshtetëror, kështu që në vetvete paraqet një fushë shumë interesante dhe të rëndësishme në kuadrin e sigurisë. Sugjerimet normalisht vijnë edhe nga një vlerësim yni, por edhe nga sugjerimi që na është bërë nga vendet partnere. Ne si Ministri e Jashtme ofrojmë si kanal komunikimi përcjelljen e këtyre mesazheve ose këto orientime të politikës sonë të jashtme, kur qëllon që në një moment të caktuar është e rëndësishme që ne bëhemi palë ose t'u afrohemi iniciativave ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit, siç është rasti konkret, ose iniciativa të tjera.

Pra, ka qenë momenti oportun që ne të vlerësonim rëndësinë e bërjes palë në këto dy instrumente.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Skapi!

Nuk e di nëse zonja Voda, dëshiron të shtojë ndonjë gjë?

Rovena Voda – Unë kisha vetëm diçka. Kjo vjen në kohë edhe për shkak se terrorizmi mbetet një nga kërcënimet më të mëdha. Unë do ta lidhja pak, pavarësisht se mbuloj një fushë me flukset migratore, nga të cilat edhe Shqipëria është prekur shumë, jo vetëm nga territori tokësor, por edhe nga pjesa e kufirit detar. Ndoshta është mirë, sepse edhe ligji për kontrollin kufitar, i përafuar me atë të BE-së, është i vitit 2014, pra një ligj i vonshëm. Këtu gjej një lidhje, por nuk di çfarë të them. Ne jemi munduar ta parashikojmë në kohë në programin analitik të akteve, pra që të mos jetë një akt që vjen me nxitim dhe, siç e dimë, ndonjëherë futen jashtë programit analitik. Kjo është përgjigjja ime.

Ermonela Felaj – Dakord.

Faleminderit!

Ndërhyrja ishte për faktin që koncepti për terrorizmin dhe terroristët ka evoluar në kohë, sidomos mbas ngjarjeve të 11 Shtatorit, që i dimë të gjithë. Prandaj, pyetja ishte për pjesën e 13 vjetëve. Ne sot kemi arritur të njohim konceptin e terroristit që vepron i vetëm, individual, dhe ky shfazimi në kohë, realisht, besoj se përbën shkak për t'u interesuar.

Fjala është për zotin Ndreu.

Pjerin Ndreu – Unë kisha një paqartësi. Në qoftë se flitet për vepra penale të ndryshme, që ndodhin në anije, si: akte terroriste e të tjera, cili është roli ndërinstitucional? Mirë Policia e Shtetit, po dogana, që merret me mallra, ku kalojnë dhe mund të futen mjete të ndryshme shpërthyesë e gjëra të tilla, që krijojnë efekte të tilla? Po kapitaneritë, pra

institucionet që kanë lidhje drejtpërdrejt me lundrimin si kombinojnë, se nuk e shoh...? Me aq sa pashë, ka të bëjë me masat, por si bashkëpunojnë institucionet? Se në çfarë niveli dhe si realizohet kjo, nuk e kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Është pjesë e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare, ku bën pjesë edhe Ministria e Financave. Kështu që do të thotë se është bashkëpunim i plotë.

Rovena Voda – Faleminderit, zoti Sinaj!

Në fakt, këtë përgjigje doja të jepja edhe unë, prandaj e përmenda në prezantimin tim të përgjithshëm, që implementimi (ishte edhe një pyetje që u bë dhe në komisionet e tjera) i është lënë QNOD-së, pikërisht për këtë arsye, bën logjikë, sepse nuk mund të jetë vetëm Ministria e Brendshme apo vetëm Ministria e Mbrojtjes, pra ka raste kur duhet të jenë të involvuar Inspektorati i Mjedisit, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pra Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Për këtë arsye, i është lënë implementimi QNOD-së.

Ermonela Felaj – Ka një pyetje zoti Vorpsi dhe besoj se nuk ka më pyetje nga kolegët.

Sadi Vorpsi – Këto detyrime mes palëve, konventat, protokollet, shoqërohen me ndonjë efekt financiar mes palëve? Kjo ishte pyetja ime.

Ermonela Felaj – Besoj se zoti Skapi mund të na japë përgjigje.

Armand Skapi – Jo, ky instrument, siç është vënë në dukje edhe analiza e bërë nga Ministria e Brendshme, nuk ka ndonjë efekt financiar. Sigurisht, bashkëpunimi ndërshtetëror nuk sjell pasojat vetëm nga instrumentet ndërkombëtare, ku ne bëjmë pjesë. Në vetvete, ky instrument nuk ka ndonjë efekt financiar, thjesht nxit bashkëpunimin ndërshtetëror, i cili është pjesë normale e programit të çdo qeverie.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se jemi të qartë për përmbajtjen e projektligjit që na propozohet.

Do t'i ftoj kolegët të kalojmë në votim, nëse nuk ka ndonjë diskutim mbas pyetjeve.

Zoti Sinaj...

Dakord.

Kalojmë te votimin e projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim.

Kush është akord me nenin 1 të projektligjit?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2 të projektligjit?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Votohet në tërësi për projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001, dhe Protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr.8850/2001”

Kush është dakord me miratimin në tërësi me këtë projektligj?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, kolegë!

Faleminderit përfaqësuesve të dy ministrive!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretar
Pjerin Ndreu**

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit
Antonela Veshi**